



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER**

**NJOFTIM PËR VEND VAKANT**

**NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR SEKRETAR PRANË PROKURORËVE**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë FIER, kërkon të punësojë në pozicionin 1 (një) punonjës në administratë me detyrë “Sekretar/e”.

Bazuar në nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në shkresën **nr. 1332 prot, dt.04.09.2020** të Prokurorisë së Përgjithshme,

**NJOFTON:**

1.Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin 1 (një) vende “Sekretar/e” në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier.

2.Referuar neneve,74,75,76, të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", kandidatët e interesuar për konkurim, përvec kushteve të përgjithshme për tu pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kritere të veçanta si më poshtë:

**Arsimi, trajnimi dhe eksperiencia:**

**1.Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- Të mos ketë marrë masa disiplinore në marrëdhënie punë dhe/ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit

- Të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi;
- Të kenë përvojë prej të paktën një viti të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë.

## **2. Kushtet e posaçme:**

- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si Microsoft: Word, Excel, PowerPoint, etj.

## **3. Kriteria të preferuara**

- Të ketë njohje të sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore;
- Të ketë kualifikime njohje ose eksperiencë në fushën e zbatimit/ praktikimit të legjislacionit përkatës në fushën e ligjeve organike të drejtësisë si dhe në fushën e arkivave;

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, deri në datën 11/12/2020 ora 16.<sup>00</sup>, këto dokumenta:

- Kërkesë për punësim.
- Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- Diplomë e shkollës së lartë, master, certifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .
- Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë FIER, deri në datën 11/12/2020 ora 16.<sup>00</sup>.

## **KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR FIER**